


Menyra e perdorimit  
te prezervativit  
mashkullor



Penisi duhet të jetë ne ereksion.



Grisni me duar mbështjelljen. Përdorni vetem prezervativa që kanë markën CE të shkruar mbi mbështjelljen.



Kujdes, thonjtë, dhëmbët dhe objektet e mprehta mund ta dëmtojnë ose ta grisin prezervativin.




Verifikoni drejtimin e shpëstjelljes së prezervativit. Shtrëngoni rezervuarin ose ekstremitetin e prezervativit në mes të gishtit tregues dhe gishtit të madh me qëllim që të largoni ajrin.




Në se seksi nuk është bërë synet, largoni së pari lëkurën nga maja e penisit.




Gjithmonë duke shtrënguar në mes të gishtave rezervuarin ose ekstremitetin e prezervativit, vendoseni atë mbi penis.



**7** Shpështilleni prezervativin në mënyrë që penisi të mbulohet tërësisht. Mos vendosni kurrë 2 prezervativa njëri mbi tjetrin (rrezik rrëshqitjeje, këputjeje...).



**8** Në se dëshëroni, mund ta lyeni prezervativin me një xhel me përbërje ujore (shitet ne farmaci, ne supermerkato...).



Gjithmonë vendosni prezervativin para se penisi të prekë partnerin/partneren tuaj. Prezervativi ju mbron nga sida dhe nga infeksionet që transmetohen seksualisht si në rastin e një depërtimi vaginal ashtu edhe në rastin e depërtimit nepermjet vrimës anale. Ai bën të mundur gjithashtu evitimn e shtatzanive te padësherueshme.



Mbas derdhjes së spermës, tërhiquni para se penisi të zbutet, duke mbajtur njëkohesisht me gishta anët e prezervativit.



Hiqni prezervativin. Sigurohuni që masa e lenget ka mbetur brenda prezervativit.



Bëni një nyje në mes të tij para se ta hidhni në kosh te plehrave (dhe jo në WC).

- W Prezervativat blihen në supermerkato, në farmaci dhe në aparatet shpërndarese.
- W Verifikoni që data e skadimit të mos ketë kaluar dhe që ambllazhi të jetë i rregullt. Mbajeni larg nga nxehtësia.
- W Ekzistojnë shumë lloje prezervativash : madhësi, përbërje, parfume të ndryshme ; me ose pa rezervuar etj.
- W Kurre nuk duhet të përdorni një prezervativ dy herë. Duhet të merrni një të ri e të përsëritni veprimin për çdo raport seksual e për çdo partener.
- W Nuk duhet të përdorni kurrë një prezervativ mashkullor e një femëror në të njëjtën kohë.
- W Mos përdorni vazelinë, gjalpë, vajra ose lëndë të tjera të yndyrshme që rrezikojnë të dëmtojnë prezervativin.
- W Në qoftë se nuk keni përdorur kurrë prezervativ, atëherë stërvituni paraprakisht...

# Menyra e perdorimit te prezervativit mashkullor



## Për më shumë informacion

Shërbimi Sida Info

**N° Vert 0 800 840 800**

Telefonatë anonime, konfidenciale dhe falas, 24 ore pa ndërprerje.

[www.sida-info-service.org](http://www.sida-info-service.org)

Lëvizja franceze për planifikimin familial

[www.planning-familial.org](http://www.planning-familial.org)

Degjimi Seksualitet Kontracepsion Dështim

**N° Vert 0 800 803 803**

(Veriu i Francës) telefonatë falas

**N° Vert 0 800 105 105**

(Jugu i Francës) telefonatë falas